

RAPORT VJETOR

2019



www.insig.com.al

Shqipëri
Rruga “Jul Variboba” Nr. 21 ,
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 400 792 ,
Fax: +35542400800 ,
E-mail: info@insig.com.al

RAPORT VJETOR

2019

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
Zhvillime kryesore.....	6
Përgjegjësia sociale.....	7
Pronësia mbi kompaninë	10
Organigrama.....	11
Organizimi i Kompanisë.....	12
Treguesit financiarë.....	13
Dëmet të paguara.....	14
Opinionit i audituesit të pavarur.....	15
Shënime mbi pasqyrat financiare.....	22
Raporti i Auditimit Të Brendshëm (Përmbledhje).....	25
Treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve ne mbulim te provigjoneve teknike.....	29

*I nderuar Aksionar,
Të nderuar Klientë dhe Partnerë,*

Ndjehem i nderuar që më është dhënë besimi nga Këshilli Mbikëqyrës i INSIG sh.a. për të qënë Drejtor



i Përgjithshëm i kompanisë së parë të krijuar në tregun e sigurimeve. Megjithëse pak muaj në drejtim gjatë vitit 2019, do të dëshiroja të theksoja bashkëpunimin e ngushtë me kolegët e mi, partnerët dhe klientët tanë, të cilët më dhanë mbështetjen në ruajtjen e stabilitetit financiar të kompanisë, si dhe duke forcuar optimizmin tim në garantimin e të ardhmes në rritje të

saj. Ne shprehim admirimin e punës që nga koha e krijimit të saj, si e para kompani sigurimesh në Shqipëri, në vendosjen e standardeve të reja për ngritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të saj në treg. Krijimi i kësaj kompanie, i vlerave dhe kulturës që demonstroi, qëndron në themel të punës sonë. Ndërtuar mbi këtë themel, qëllimi ynë është që të bindim klientët tanë se ne jemi vërtet kompania më e sigurtë në treg dhe se e ardhmja do të jetë e konsoliduar duke ofruar një shërbim cilësor, kompetitiv dhe bashkëkohor. Duke marrë në konsideratë këto qëllime, mesazhi ynë për investitorët është se, për të ecur përpara, ne do të përqëndrohemi pikërisht në atë çfarë ne kemi bërë dhe do të bëjmë për të rritur rezultatet tona. Treguesit ekonomikë dhe financiarë deshmojnë se INSIG sh.a. ka përmbushur konsiderueshëm objektivat e vendosura nga programi financiar dhe i veprimtarisë shoqërisë, duke mbajtur nivelin e duhur të kapitalit si dhe duke investuar mjetet e saj në tregun financiar në funksion të garantimit të aftësisë paguese dhe prezencës në treg. Jemi pjesë e një industrie sigurimesh me peshën dominuese të sigurimit të detyrueshëm (Raporti i sigurimeve të detyrueshme kundrejt atyre vullnetare në Shqipëri është 69% me 31%), fakt i cili ndikohet së tepërmi nga mjaft faktorë socialë-ekonomikë. Pavarësisht politikave orientuese të shoqërisë, të cilat kanë qënë drejt rritjes së tregut të sigurimeve vullnetare kundrejt atyre të detyrueshme, gjatë vitit 2019, ashtu si dhe vetë industria e sigurimeve në vend, INSIG sh.a vazhdon të ruajë një peshë deri në 16.55% të tyre ndaj totalit të portofolit të tij, fakt që bën që ndryshimi i këtij raporti të mbetet ende në prioritetet për të ardhmen. Niveli i të ardhurave të realizuara nga primet e sigurimit gjatë vitit 2019 për të gjithë tregun ishte rreth 17.6 miliardë lekë, me një kontribut prej 6.91% të tyre nga Shoqëria INSIG sh.a, duke u renditur e shtata në treg, ndërkohë konsideruar si Grup EVROSIG -INSIG kontributi në të ardhurat nga primet ishte 21.05% e volumit të përgjithshëm. Sa i takon pagesave për dëme që u realizuan nga tregu i sigurimeve gjatë vitit 2019, 5.25% ishte kontributi i shoqërisë INSIG në totalin e përgjithshëm për dëme të paguara. Duhet theksuar këtu që rreth 57 milionë lekë janë kryer për praktika dëmsh që i takojnë Fondit të Kompensimit ose 9.4% të pagesave mbi totalin e tregut. Të gjithë këta tregues pozitiv janë realizuar falë përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të shoqërisë kujdesit dhe mbështetjes së aksionarit dhe Këshillit Mbikëqyrës. Dëshiroj të falenderoj të gjithë klientët dhe partnerët për besimin dhe partneritetin me ne. Përfundimisht, në emër të kompanisë do të dëshiroja të falenderoj ata të cilët kanë garantuar këtë stabilitet të saj, pikërisht stafin punonjës për punën dhe përkushtimin e tyre. Shpreh besimin se përpjekjet tona do ta çojnë INSIG sh.a drejt konsolidimit dhe suksesit.

*Gëzim Tola
Drejtori i Përgjithshëm*

ZHVILLIME KRYESORE

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, viti 2019 Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2019 kapën vlerën mbi 17,618 milionë lekë, ose 4.11% më shumë se në vitin 2018. Gjatë vitit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,350,075 me një rritje 3.18% krahasuar me vitin 2018. Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.73% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.90% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.37%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.30% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.70% të totalit të tregut. Gjatë vitit 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,377 milionë lekë, ose 8.58% më pak se në vitin 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2019 kapën vlerën mbi 17,618 milionë lekë, ose 4.11% më shumë se në vitin 2018. Gjatë vitit 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,350,075 me një rritje 3.18% krahasuar me vitin 2018





Ndër vite Grupi Eurosig-Insig ka një vëmendje të shtuar ndaj përgjegjësisë sociale. Falë angazhimit dhe kujdesit të vazhdueshëm të Presidentit, z. Kadri Morinaj, Eurosig-Insig ka angazhuar burime njerëzore dhe financiare, të cilat janë në dispozicion të drejtpërdrejt të shoqërisë dhe mjedisit ku Eurosig-Insig ushtron veprimtarinë e saj, por dhe më gjerë, mjedisit kulturor, artistik, mediatik etj. Një vëmendje të veçantë Grupi Eurosig-Insig dhe Presidenti Morinaj ka edhe ndaj shtresave në nevojë.

Nga veprimtaritë e mbështetura financiarisht për vitin 2019 nga Grupi Eurosig-Insig dhe Presidenti z. Kadri Morinaj, veçojmë:

Nëntor 2019 – Në shenjë solidarizimi me dhimbjen e të gjithë shqiptarëve të prekur nga pasojat e tërmeteve dhe me heronjtë që u angazhuan të shpëtojnë jetë njerëzish, në një mbledhje të jashtëzakonshme, Asambleja e Aksionarëve dhe Bordi Drejtues i Grupit Eurosig-Insig, vendosi t'i akordojë menjëherë Komitetit të Emergjencave 50 000 Euro ndihmë për përballimin e situatës.

Edhe mbrëmja e fundvitit në Grupin Eurosig-Insig këtë radhë ishte ndryshe nga vitet e kaluara. Stafi i shoqërive Eurosig dhe Insig u solidarizuan dhe u impenjuan për të mbledhë fonde në ndihmë të të dëmtuarve nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 në Shqipëri.

Tetor 2019 - Grupi Eurosig-Insig, nën kujdesin e Presidentit Morinaj, mbështeti botimin e librit poetik “Shami të zeza qiellore”, të Mjeshtrit të Madh Petrit Ruka. Në promovimin e këtij libri të moderuar nga Z. Pëllumb Kulla, Grupi Eurosig-Insig u vlerësua maksimalisht për kontributin e dhënë në mbështetje të artistëve dhe shkrimtarëve, duke nxjerrë në pah vlerat sociale e kulturore. Me botimet që Z. Morinaj ka mbështetur financiarisht, Grupi Eurosig-Insig mund të konsiderohet një bibliotekë kombëtare.

Nëntor 2019 – “Studentët për Qeverisjen e Mirë” titullohej Forumi Kombëtar i mbështetur fuqimisht nga Grupi Eurosig-Insig. Qindra studentë pjesëmarrës, të përkushtuar për të kontribuar në një qeverisje më të mirë, paraqitën punimet dhe tezat e tyre, duke parashtruar shumë alternativa në funksion të Qeverisjes së Mirë.

Nëntor 2019 - Grupi Eurosig-Insig, nën kujdesin e Z. Kadri Morinaj, mbështeti spektaklin 3-ditor në qytetin e Kukësit “Netët e Kinemasë Evropiane”. Ky spektakël u mirëprit mjaft ngrohtë nga qytetarët kuksianë, nën moderimin e ëmbël të Silvana Braçes.

Dhjetor 2019 - Edhe këtë vit Grupi Eurosig-Insig u bë pjesë e kontributit për organizimin e Festivalit të 58-të Këngës në RTSH. Fituesi i kompeticionit më të rëndësishëm në vend do të përfaqësonte Shqipërinë në Eurovizion.

Dhjetor 2019 – Eurosig-Insig financoi blerjen e uniformave shkollore për fëmijët e 100 familjeve në nevojë, të cilët frekuentojnë Shkollën 9-vjeçare “Riza Spahiu”, në Kukës, duke mundësuar që ata të ndihen të lumtur dhe të barabartë me fëmijët e tjerë.

Dhjetor 2019 – Duke fluturuar mbi majat më të larta të Shqipërisë, Alket Islami realizoi albumin fotografik “Alpet Shqiptare”. Ky album, i mundësuar edhe nga Grupi më i madh i Sigurimeve në vend, Eurosig-Insig, pasuron dijen dhe bibliotekën tuaj.

Veprimtari të tjera në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe edukimit të konsumatorit:

Nëntor 2019 - Edukimi dhe informimi mbi rëndësinë e sigurimeve është një mision që ka nisur fillimisht me të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, së bashku me Shoqatën e Siguruesve. Mesazhi që përcillet në këto veprimtari është: “Për të kuptuar rëndësinë e sigurimeve nuk duhet të presim deri kur konsumatori të ketë kosto të larta nga dëmet e shkaktuara, por të paraprijmë riskun, duke e transferuar atë tek Shoqëritë e Sigurimit”.

Nëntor 2019 – Në Ditën e Sigurimeve në Universitetin European të Tiranës, Shoqata e Sigurimeve, bashkë me Eurosig-Insig, zhvilloi një Leksim të Hapur informues dhe edukativ me studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit pranë UET-së. Leksimi kishte për qëllim prezantimin e kulturës së edukimit mbi sigurimet në Shqipëri, e cila është një sifidë e rëndësishme shoqërore



që kërkon kontributin e një game të gjerë faktorësh, bashkëpunëtorësh dhe përfituesish.

Nëntor 2019 - Suksesi i z. Veton Kurtmajlaj dhe historia e tij frymëzuese ishin objekt i emisionit në RTV Ora që promovon suksesin e të rinjve me aftësi të kufizuara. Z. Kurtmajlaj, i cili fitoi bursë studimesh nga Eurosig, me iniciativën e Z. Kadri Morinaj u punësua në Eurosig, ku aktualisht drejton me përkushtim dhe standarde profesionale Sektorin e Analizës dhe Statistikës.

Shkurt 2019 - Eurosig & Insig morën pjesë në aktivitetin Team Building të organizuar nga ISN Albania, tek Vila Toscana. Qëllimi i këtij trajnimi të organizuar për punonjësit e Grupit Eurosig-Insig, sa praktik po aq edhe dinamik, ishte zhvillimi dhe rritja e efektivitetit të aftësive për punën në grup.

Qershor 2019 - Stafi i Eurosig, në udhëtimin Tiranë - fshati Vuthaj, iu bashkëngjiti grupit turistik në malet e Alpeve, duke realizuar ngjitjen e malit për tek tre liqenet e mrekullueshme të Jezercës.

PROMOVIMI I VLERAVE TË EUROSIG, ÇMIME, VLERËSIME

Edhe viti 2019 u shoqërua me promovim vlerash, çmime dhe vlerësime kombëtare dhe ndërkombëtare:

Janar 2019 – Në Paris, në edicionin e 42-të të ndarjes së çmimeve të më të mirëve në fusha të ndryshme, presidenti i Grupit Eurosig-Insig, Z. Kadri Morinaj, u vlerësua me çmimin “The Best Awards”, si biznesmen i suksesshëm në ndihmë të njerëzve në nevojë dhe gjithashtu në fushën e filantropisë. Pas marrjes së çmimit nga kryetarja e Bashkisë së Parisit, Jeanne d’Hauteserre, Z. Morinaj e konsideroi atë “si një privilegj, pasi në traditën e krijuar ky çmim u jepet personaliteteve me emër në botë”.

Me këtë rast, Z. Dritan Tola, ambasador i Shqipërisë në Francë, tha: “Këtë vit çmimi iu dha një shqiptari, Zotit Kadri Morinaj, i cili është një nga përfaqësuesit e shquar në Shqipëri, por dhe në botë, një nga pionerët e kapitalizmit shqiptar, një kapitalizëm me fytyrë humane pikërisht për shkak të aktiviteteve që ai ka zhvilluar dhe në fushën sociale”.



Kurse Jean Marie Ruard, anëtar i Akademisë së Shkencave të Parisit, theksoi: “Është një nga mbrëmjet më të veçanta në Paris, ku kam takuar edhe shkrimtarin më të njohur shqiptar, Ismail Kadarenë. Vlerësoj Zotin Morinaj për kontributin e tij të dhënë. Figura të tilla na duhen gjithmonë”.

Në këtë ceremoni, Jean Senastien Robine, President i Grupit të Liderëve të Rinj Gjenevë, u shpreh: “... Unë jam një biznesmen i ri dhe ndjem në privilegj që e mora këtë çmim në krah të mikut tim nga Shqipëria, Zotit Kadri Morinaj ...”

Mars 2019 - Presidenti i Grupit Eurosig, Z. Kadri Morinaj, ishte i ftuar në Londër për një darkë pune nga një prej familjeve më në zë dhe më të fuqishme në industrinë bankare të botës, familja Rothschild. Gjatë darkës, Z. Morinaj qëndroi me Baronin David René James de Rothschild, bankier francez, anëtar i degës franceze të familjes Rothschild në Britaninë e Madhe dhe kryetar i Rothschild Continuation Holdings. Gjatë prezantimit të vlerave të Grupit Eurosig, Z. Morinaj diskutoi dhe u konsultua me Baronin londinez për industrinë e sigurimeve dhe sistemin bankar në rajonin e Ballkanit.

Theksojmë se, që nga viti 2008, David de Rothschild ka qenë Kryetar i N.M.Rothschild&Sons, Kryetar i Rothschild Holdings Continuation, Zëvendëskryetar i Rothschild Bank AG, Zëvendëskryetar i Bordit Mbikëqyrës

të Paris Orleans, Partner i Lartë i Rothschild&Cie Banque, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Compagnie Financiere Saint-Honore, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Compagnie Financiere Martin Maurel, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Grupit De Beers, Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Groupe Casino.

Korrik 2019 – Grupi Eurosig-Insig mori çmimin PLATINIUM për Cilësi dhe LiderShip, në konventën ESQR për zgjedhjen e Çmimit të Cilësisë, që u mbajt në Berlin të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e organizatave dhe kompanive nga Europa, Azia, Amerika dhe Australia. Liderët e biznesit nga të gjitha vendet, ekspertë, akademikë dhe diplomatë merrnin pjesë duke sjellë eksperiencën



"Summer Dinner de Club des Leaders", në Gjenevë. I pranishëm në këtë



reciproke. Në kohën e lirë, Grupi Eurosig ofroi një udhëtim të këndshëm një ditore me jaht, përgjatë brigjeve të mrekullueshme të rivierës franceze.

Tetor 2019 - EUROSIG u rendit nga SeeNews në vendin e 78-të mes qindra kompanive të sigurimit. SEE TOP 100 është rankimi i sigurveve më të mëdhenj në Europën Lindore. Burimi i të dhënave mbi kompanitë e sigurimit janë bankat qendrore, regjistrat kombëtarë, autoritetet financiare, qeveritë, korporatat dhe vetë kompanitë.

Dhjetor 2019 – Shkolla "Riza Spahiu", në Kukës, i akordoi Grupit Eurosig-Insig dhe Z. Kadri Morinaj Certifikatë Mirënjohje për ndihmën e vazhdueshme në mbështetje të nxënësve të kësaj shkolle.

Në situatën e krijuar nga pandemia e COVID 19, Grupi Eurosig-Insig ndërmori një fushatë unike duke u shpërndarë pako me ndihma ushqimore dhe sanitare familjeve që janë në vështirësi ekonomike. Harta e familjeve që kanë përfituar ndihma nga Grupi Eurosig-Insig dhe Presidenti i Grupit. Z. Kadri Morinaj, shtrihet në bashkitë Tiranë, Korçë, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Fier, Sarandë, Lushnjë, Elbasan, Pogradec, Gjirokastrë, Mirditë, Laç, Përrenjas, Librazhd, Belsh, Cërrik, Peqin, Gramsh, Klos, Mat, Peshkopi, Bulqizë, Kukës, Has, Pukë, Kamëz, Tropojë, Kavajë, Konispol, Ksamil, Tepelenë, Dropull, Bilisht, Skrapar, Fushë-Arrëz, Memaliaj, Maliq. Por këto kontribute, si dhe veprimtari të tjera të shumta gjatë kësaj periudhe në kuadër të përgjegjësisë sociale, do të publikohen në Raportin Vjetor të vitit 2020.

të jashtëzakonshme të menaxhimit dhe lidershit. Zoti Kreshnik Morinaj, që përfaqëson Grupin Eurosig-Insig, ishte në fakt emblema e vërtetë e gjithë asaj për të cilën flitej në këtë konventë: lider ship, menaxhim dhe cilësi, si kryefjalë e biznesit.

ESQR është shoqëria europiane për kërkime në cilësi, me qendër në Lozanë të Zvicrës, e cila merret me kërkime strategjike në cilësinë e menaxhimit dhe për përmirësimin dhe promovimin e kulturës të cilësisë, ku shërben si një forum global në çështje të tilla. Pikërisht nga ky organizëm prestigjioz, Grupi Eurosig-Insig mori Çmimin e Cilësisë të vitit 2019, PLATINIUM CATEGORY.

Korrik 2019 - Presidenti i Grupit Eurosig-Insig, Z. Kadri Morinaj, ishte i ftuar për të marrë pjesë në eventin takim ishte presidenti i Club De Leaders, Jean Sebastian si dhe Princesha e Italisë, Marie Gabrielle de Savoie. Në këtë mbledhje u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të investimeve në Shqipëri.

Qershor 2019 - Presidenti i Grupit Eurosig-Insig, Z. Kadri Morinaj, mori pjesë në aktivitetin e START UP CITY, një aktivitet me ide novatore. Në fjalën e tij, Z. Morinaj motivoi të rinjtë për të realizuar ëndrrat e tyre në vetëbesim, iniciativë dhe sinjeritetit në rregullat e lojës së biznesit.

Shtator 2019 - Stafet e specializuara të subjekteve të Grupit Eurosig-Insig në Shqipëri dhe Kosovë morën pjesë në edicionin e 63-të të Monte Carlo Reinsurance Rendezvous Septembre 2019, në Monako, ku sigurvezit, risigurvezit, ndërmjetësit etj. takohen për të diskutuar të ardhurat e risigurimit të sezonit të ri dhe ndarë përvojat

PRONËSIA MBI KOMPANINË

Ne përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar ,pas ndarjes se aktivitetit ne 01.01.2017 ne INSIG Jete dhe INSIG sh.a., është 650,000,000 lekë (gjashtëqind e pesëdhjetë milion), i ndarë në 1,083 (njëmijë e tetëdhjetë e tre) aksione, me vlerë nominale 600.184,672 lekë secili. Gjatë vitit 2016, aksionet e shoqërisë iu shiten në masën 100% shoqërisë se sigurimeve Eurosig sh.a.

Këshilli Mbikqyrës:


Vasil Pilo – Kryetar

Rexhep Meidani – Anëtar

Thanas Xhillari – Anëtar



Organigrama 2019



Organizimi i Kompanisë

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.

Degët dhe numri i punonjësve per vitin 2019

Shqipëri

Nr.rendor	Degët / Agjensitë	Nr. i punonjësve
1	BERAT	5
2	DIBËR	3
3	DURRËS	5
4	ELBASAN	4
5	FIER	3
6	GJIROKASTËR	3
7	KAVAJË	3
8	KORCË	5
9	KUKËS	3
10	LAÇ	1
11	LEZHË	3
12	LUSHNJË	3
13	POGRADEC	4
14	SARANDË	3
15	SHKODËR	7
16	TIRANË 1	11
17	TIRANË 2	6
18	TIRANË 3	13
19	VLORË	5
	Total Degë/ Agjenci	90



TREGUESIT FINANCIARË

AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2019 u shkruan 1,129,240 mijë lekë prime nga sigurimet e jo-jetës për INSIG sha në territorin e Shqipërisë. Rreth 83% e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 17% nga sigurimet e pronës dhe te shëndetit.

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për INSIG sh.a Shqiperi :

Lloji i produktit	viti 2019	viti 2018
Mjete motorrike	83 %	86 %
Pasuri	16 %	12 %
Shëndet	1 %	2 %
Totali	100%	100%



DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2019 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2019 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 292,208,000 lek

Dëme të paguara në lekë (në vite)	
2019	292,208,000 lek
2018	350,996,000 lek





Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për Qëllime të Veçanta

INSIG sh.a

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iv
Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital	3
Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta	5-51

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për bordin drejtues dhe aksionerët e INSIG sh.a

Opinion me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta të INSIG sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e raportit tonë Bazat për Opinionin me Rezervë, pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bazat për Opinionin me Rezervë

1. Sikurse është paraqitur në shënimin 2, *Bazat e përgatitjes*, dhe shënimin 16 *Marrëdhënie me Degën Insig sh.a Kosovë ('Dega')*, të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta bashkëlidhur, Shoqëria nuk ka kryer kombinimin sipas secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës së saj Insig Sh.a Kosovë. Sikurse tregohet në shënimin 16, *Marrëdhënie me Degën Insig*, Banka Qëndrore e Kosovës më datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën a Insig Dega Kosovë, ka njoftuar hapjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm si edhe ka caktuar një likuidator. Marrëdhënia me Degën përfshin, fondet e transferuara për shtesa në kapitalin e Degës, humbjet e mbartuara dhe humbjen e periudhës së mbyllur me 31 mars 2019 të Degës, si edhe efektin e kursit të kembimit të vitit të njohur në vitin 2018. Nëse Shoqëria do të kishte kryer kombinim për secilën kategori të aktiveve dhe detyrimeve të saj si edhe kombinimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me pasqyrat financiare të Degës, fitimi i vitit do të rritej me fitimin e vitit të Degës, si dhe detyrimi për Marrëdhënien me Degën Insig sh.a Kosovë, i cili paraqitet në këto pasqyra si një zë i vetëm në pasqyrën individuale të pozicionit financiar, do të shpërndahej në vlerat përkatëse të secilës kategori të aktiveve dhe detyrimeve. Për më tepër, ne nuk na është mundur bilanci i ri i gjendjes të Insig Dega Kosove në likuidim dhe konfirmimi i të drejtave dhe detyrimeve prej/të Insig Sh.a kundrejt Insig Dega Kosovë prej likuidatorit. Rrjedhimisht, në pamundësi për të kryer procedura alternative dhe për të marrë evidence të mjaftueshme dhe të duhur, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim do të jetë i nevojshëm në lidhje me validitetin, plotësinë, existencën dhe saktësinë e vlerës së detyrimeve neto të detyrimeve të përfshirë nën një zë të vetëm nën marrëdhënie me degën Insig Kosovë – shenimi 16.

2. Siç është prezantuar në shënimin 14, Aktive Afatgjata Materiale, Shoqëria ka rivlerësuar vlerën e drejtë për disa ndërtesa në vitin 2018. Vlera e drejtë dhe e rikuperueshme e investimeve në ndërtesa dhe pasuri të paluajshme është përcaktuar nga një vlerësues i jashtëm pronash i cili ka përdorur metodën e krahasimit për vlerësimin e ndërtesave. Ne nuk mund të merrnim evidenca të përshtatshme dhe të mjaftueshme për tu mbështetur në vlerësimin me bazen e krahasueshmërisë të kryer nga Shoqëria për përcaktimin e vlerës së drejtë dhe të rikuperueshme të ndërtesave. Si rrjedhim, ne nuk mund të merrnim sigurinë e mjaftueshme dhe të duhur për të përcaktuar nëse ka nevojë për rregullime në lidhje me vlerën e drejtë dhe vlerën e rikuperueshme të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë si edhe për rezervën e rivlerësimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.
3. Sikurse është paraqitur në shënimin 2 d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional, Shoqëria nuk ka përfshirë, në përllogaritjet e treguesve rregullatore, humbjet e akumuluar deri më 31 dhjetor 2019 në vlerën prej 1,347,260 mijë lek, ku përfshihen edhe humbjet e mbartura të Degës Insig Kosova deri më 31 mars 2019 për vlerën prej 1,860,385 mijë lek, gjë e cila ka ndikuar ndjeshëm në përllogaritjen e këtyre treguesve gjatë vitit 2019 (Anekset Suplementare). Sikurse tregohet në shënimin 16, Marrëdhënie me Degën Insig Kosovë, Banka Qëndrore e Kosovës më datë 26 prill 2019 ka revokuar licencën e Insig Dega Kosovë, ka njoftuar hapjen e procedurës së likuidimit të detyrueshëm si edhe ka caktuar një likuidator. Marrëdhënia me Degën Insig Kosovë mbetet ende e pasigurtë deri në përfundimin e procesit të likuidimit. Gjithashtu, sic është paraqitur në shënimin 13, aktive të tjera, gjatë vitit 2019, Shoqëria ka dhënë parapagime ndaj punonjësve në vlerën 102,337 mijë lekë, Huaja ndaj Eurosigs Sh.a është rritur në 643,437 mijë lekë dhe parapagimet ndaj pronarit nuk janë ulur. Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) më anë të vendimit të Bordit numër 149 datë 27.10.2017 i Bordit parashtron masat administrative, ndër të tjera, ndalimin e transaksioneve me palet e lidhura dhe punonjësit dhe aksionaret si edhe hartimin e planit për përmirësimin e treguesve rregullatorë të Shoqërisë. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë provizion lidhur me ndëshkimet që mund të ndodhin sa i përket mospërputhjeve me kërkesat rregullatore të lartëpërmendura.

Rrethanat e përshkruara më sipër dhe të tjera të përshkruara në shënimin 2d, tregojnë ekzistencën e një pasigurie materiale që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë.

Për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafet e mësipërme ne nuk mund të përcaktojmë nëse rregullime në raportin e aktiveve për mbulim e detyrimeve të sigurimit do të ishin të nevojshme.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare për Qëllime të Veçanta. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare për qëllime të veçanta në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale për qëllime të veçanta.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Kuadri Kontabël dhe Kufizimi në Përdorim dhe Shpërndarje

Pa modifikuar opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 të pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta, i cili përshkruan bazat e raportimit financiar. Këto pasqyra financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në mënyrë që Shoqëria të raportojë aktivitetin në territorin e Shqipërisë i cili është subjekt i supervizionimi të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri. Si rezultat i kësaj, pasqyrat financiare për qëllime të veçanta mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti ynë është përgatitur vetëm për përdorim nga ana e Shoqërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ("AMF") në Shqipëri, dhe nuk duhet të përdoret ose shpërndahet nga/në asnjë palë tjetër përveç Shoqërisë dhe AMF.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të aftësisë Paguese dhe Aktivit për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

29 prill 2020

Mediana Kodra, FCCA

[Signature]



Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	8	5,882,846	18,165,212
Depozita me afat me bankat	9	477,126,898	376,114,781
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	10	233,168,063	53,366,258
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	11	160,663,722	179,086,073
Aktive të risigurimit	12	200,763,645	303,633,059
Aktive të tjera	13	1,327,479,699	935,242,955
Aktive afatgjata materiale	14	529,218,018	504,155,697
Aktive afatgjata jo-materiale	15	5,155,084	3,917,372
Pjesëmarrje në shoqëri të kontrolluara	17	-	380,245,000
Hua subordinuese në shoqëri të kontrolluara	18	-	128,623,505
TOTALI I AKTIVEVE		2,939,457,974	2,882,549,912
DETYRIMET			
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	19	871,988,997	948,659,548
Rezerva për primet e pafituara	20	565,893,040	510,224,108
Të pagueshme ndaj risiguruesve	21	8,973,962	10,315,117
Detyrimet e qirasë	22	13,831,189	-
Hua Bankare	23	141,939,192	168,065,271
Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera	24	94,400,816	109,599,861
Provizione	25	15,072,696	360,860
Tatim i shtyrë		2,333,154	2,333,226
Marrëdhënie me degën Insig Sh.a Kosovë	16	528,217,300	518,612,525
Te pagueshme për tatim fitimin		10,266,026	1,748,731
TOTALI I DETYRIMEVE		2,252,916,373	2,269,919,247
KAPITALI			
Kapitali aksionar	26	650,000,000	650,000,000
Rezerva rivlerësimi	27	279,684,643	279,684,643
Rezervë për parandalimin e dëmeve	28	44,677,559	44,677,559
Rezerva të tjera	29	1,050,611,336	1,050,611,336
Rezerva nga kursi këmbimit		8,828,000	8,828,000
Fitimi i vitit		83,515,719	32,360,451
Humbje të mbartura		(1,430,775,655)	(1,453,531,324)
TOTALI I KAPITALIT		686,541,601	612,630,665
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,939,457,974	2,882,549,912

Këto pasqyra u miratuan nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 20 prill 2020 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Z. Gezim Tola
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Ola Murataj
Shef i Departamentit të Finance-Kontabilitetit

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 51, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta.



Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse

		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Shënime		
Prime të shkruara bruto	30	1,129,175,075	1,093,464,534
Ndryshimi neto në rezervën për primet e pafituara		(55,668,933)	41,428,432
Prime të ceduara risiguresit	31	(65,841,940)	(71,191,078)
Ndryshimi në prime të ceduara risiguresit		1,452,117	(5,224,267)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		1,009,116,319	1,058,477,621
 Të ardhura të tjera	32	12,375,323	23,739,033
Humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjes		(305,698,103)	(293,311,476)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	33	(331,313,633)	(309,974,857)
Shpenzime administrative	34	(444,380,711)	(399,259,859)
		(1,280,716)	-
Fitimi pas rregullimeve të humbjeve		(1,070,297,839)	(978,807,159)
 Të ardhura financiare	35	6,261,321	5,323,329
Shpenzime interesi		4,730,836	(10,782,606)
Fitimi nga kurset e këmbimit, neto	36	(17,422,991)	(33,809,611)
		169,007,000	-
(Shpenzime) të ardhura financiare neto		162,576,167	(39,268,888)
 Fitimi para tatimit		101,394,646	40,401,574
 Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	37	(17,878,934)	(8,041,123)
 Fitimi neto i vitit		83,515,712	32,360,451
 Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		83,515,712	32,360,451

Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse duhet lexuar se bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 51, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksonar Lek	Rezerva rivlerësimi Lek	Rezerva për dëme Lek	Rezerva të tjera Lek	Rezerva konvertimi Lek	Fitimi i Pashpërdare Lek	Totali Lek
Gjendja më 1 janar 2018	650,000,000	171,647,635	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,540,253,051)	385,511,479
Ulje e rezervave nga shifra e aktiveve fikse	-	(18,912,540)	-	-	-	-	(18,912,540)
Rritje e rezervave të rivlerësimit nga rivlerësimi pronave	-	126,949,548	-	-	-	-	126,949,548
Rezerve rivlerësimi nga kursi i kembimit i degës Insig Kosovo	-	-	-	-	-	150,708,040	150,708,040
Humbje neto per periudhen, Dega Insig sh.a Kosove	-	-	-	-	-	(63,986,313)	(63,986,313)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	32,360,451	32,360,451
Gjendja më 31 dhjetor 2018	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,421,170,873)	612,630,665
Gjendja më 1 janar 2019	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,421,170,873)	612,630,665
Ulje e rezervave nga shifra e aktiveve fikse	-	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervave të rivlerësimit nga rivlerësimi pronave	-	-	-	-	-	-	-
Rezerve rivlerësimi nga kursi i kembimit i degës Insig Kosovo	-	-	-	-	-	-	-
Humbje neto per periudhen, Dega Insig sh.a Kosove	-	-	-	-	-	(9,604,775)	(9,604,775)
Fitimi neto i vitit	-	-	-	-	-	83,515,712	83,515,712
Gjendja më 31 dhjetor 2019	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	(1,347,259,936)	686,541,602

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 51, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Pasqyra Individuale e Flukseve të Parasë

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fitimi/(Humbja) para tatimit		101,394,646	40,401,573
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlërësimi dhe amortizimi	14,15	48,476,746	29,118,521
Fitim i shitjes së shoqërive të kontrolluara		(169,007,000)	-
Nxjerrje jashtë përdorimit /(fitim) nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	2,635,925
Shpenzime interesi		4,730,836	10,782,606
Të ardhurat nga interesi		(6,261,321)	(5,323,329)
		(20,666,093)	77,615,296
			-
<i>Ndryshimi në :</i>			
(Rritje)/rënie në llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera të arkëtueshme		(179,801,805)	(6,864,997)
Rënie/(rritje) në koston e shtyrë të marrjes në sigurim		18,422,351	35,670,194
(Rritje)/rënie në aktive të risigurimit		102,869,414	(82,207,895)
Rënie/(rritje) në aktivet e tjera		(392,236,744)	226,072,413
Rritje/(rënie) në provigjionet e kontratave të sigurimit		(76,670,551)	114,341,727
Rritje/(rënie) në rezerva për primet e pafituara		55,668,932	(41,428,432)
Rritje/(rënie) në detyrime ndaj risigurve		(1,341,155)	9,366,294
Rritje/(rënie) në qera financiare		13,831,189	(1,170,893)
Rritje/(rënie) në llogaritë të pagueshme		(15,199,045)	(98,853,374)
Rritje/(rënie) provigjone të tjera		14,711,760	-
Interesi i paguar		(4,730,836)	(10,782,606)
Tatimi i paguar mbi fitimin		(9,361,639)	(786,550)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet operative		(494,504,223)	220,971,177
			-
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Marredhënie me Insig Sh.a Kosovë		-	(65,522,696)
(Rritje) rënie në të arkëtueshme nga Shoqëritë të kontrolluara		128,623,505	(133,612,530)
(Rritje) rënie në investime në Shoqëritë të kontrolluara		549,252,000	-
Blerje të aktiveve afatgjata materiale		(74,102,090)	(6,105,099)
Pakesime të aktiveve afatgjata		1,197,588	4,189,663
Pakesime të aktiveve afatgjata		(1,872,272)	-
Rënie/(rritje) në depozitat me afat		(100,635,055)	6,573,000
Interesi i arkëtuar		5,884,259	5,758,017
Flukset monetare neto të gjeneruara në aktivitetet investuese		508,347,935	(188,719,645)
			-
Flukset monetare nga aktivitetet financiare			
Disburesime të kredise bankare		-	(22,613,429)
Shlyerje e kredise bankare		(26,126,079)	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet financiare		(26,126,079)	(22,613,429)
			-
Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(12,282,366)	9,638,103
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit		18,165,212	8,527,109
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit	8	5,882,846	18,165,212

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shenimet shpjeguese në faqet 5 deri 51 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare individuale për qëllime të veçanta.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare Individuale për Qëllime të Veçanta

1. Informacion i përgjithshëm

INSIG Sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në 1991 si një shoqëri sigurimi në atë kohë 100% në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave. Aktiviteti kryesor i biznesit të saj përfshin sigurimin e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pronë, jetë, marinë dhe lloje të tjera sigurimi. Zyrat kryesore të INSIG-ut janë në Rruga "Jul Variboba", Nr 21, Tiranë, Shqipëri.

Më 1 mars 2000 Shoqëria çeli një degë në Kosovë ("Dega"). Kjo degë ofron kryesisht sigurime të mjeteve motorike dhe sigurim i palëve të treta në të gjithë territorin e Kosovës.

Më 8 mars 2003, Shoqëria filloi të operojë edhe në territorin Republikës të Maqedonisë nëpërmjet INSIG AD, Shkup e cila pas privatizimit të Insig Sh.a, Shqipëri ndyshoi emrin në Eurosig AD, Shkup ("Shoqëri e Kontrolluar"). Eurosig AD, Shkup është 100% në pronësi të INSIG Sh.a.

Më 19 mars 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimin e pronësisë së kompanisë mëmë nga Ministria e Financës tek Ministria e Ekonomisë dhe gjithashtu anuloi rregulloren paraprake për privatizimin e "Insig" duke e konsideruar si sektor strategjik.

Më 23 mars 2016, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, "Eurosig" sh.a, një Shoqëri e sigurimit të jo-jetës që operon në Shqipëri, u shpall fitues i procedurës së privatizimit të Insig sh.a. Më 1 qershor 2016, u nënshkrua marrëveshja e blerjes dhe u morën aprovimet e nevojshme rregullatore dhe më 2 qershor 2016 u krye transferimi i aksioneve nga Ministria e Ekonomisë të Eurosig sh.a. si dhe u bë regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ("QKR").

Më 31 dhjetor 2019, Insig sh.a numëron 137 të punësuar si personel dhe nivel drejtues (2018 145 persona staf dhe nivel drejtues).

Shoqëria, me anë të vendimit të Aksionareve numër 16, datë 23 dhjetor 2016 vendosi:

- 1) miratimin e ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy Shoqëri pritëse të themeluara rishtazi: Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete sh.a.
- 2) miratimin e marrëveshjes së ndarjes së Shoqërisë Insig sh.a në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi Insig sh.a (shoqëri sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me anë të vendimit numër 202, datë 27 dhjetor 2016 miratoi ndarjen e veprimtarisë së shoqërisë "Insig" sh.a. në shoqërinë e sigurimit "Insig" sh.a, e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jo-Jetes dhe në shoqërinë e sigurimit "Insig Jete" sh.a, e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jetës, efekte të cilat nisin prej 1 janar 2017.

Asambleja e përgjithshme e Insig Sh.a me anë të vendimit 710/1, datë 28.03.2018 miratoi ndarjen e pasqyrave financiare me 1 janar 2017 të aktivitetit të Shoqërisë Insig Jeta sh.a dhe Shoqërisë Insig Sh.a.

2. Bazat e përgatitjes

a) Bazat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare individuale për qëllime të veçanta (pasqyrat financiare) janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në vlerësimin, paraqitjen, dhe parimet kontabël sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), përveç mungesës së konsolidimit të degës Insig Sh.a në Kosovë. Me poshtë paraqiten parimet kryesore të politikave kontabel të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta.

Shoqëria mëmë Eurosig sh.a përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin Eurosig Sh.a, i cili përfshin Eurosig Sh.a në Shqipëri, Eurosig Kosova Sh.a dhe Insig sh.a së bashku me degën Insig sh.a në Kosovë dhe Investimin në Shoqërinë e Kontrolluar Insig - Maqedoni. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Degët si edhe Shoqëritë e Kontrolluara, në të cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në faqen zyrtare të Shoqërisë Mëmë Eurosig sh.a. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare për qëllime të veçanta duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Grupit në tërësi.

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë përgatitur në bazë të kostos historike.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare për qëllime të veçanta janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

d) Përdorimi i vlerësimit dhe i gjykimit profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe në periudha të ardhshme që rishikimi ndikon.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) nuk ka pranuar llogaritjen e treguesve rregullatore nga Shoqëria, gjë të cilën e ka komunikuar nëpërmjet shkresës 3264, datë 17.10.2019, ku ndër të tjera ka kërkuar prej Shoqërisë arsyetim ligjor dhe një vendimarrje të Autoritetit Mbikëqyrës në Kosovë për vlerën përfundimtare të detyrimit për Insig Kosovë (nëse do të ketë) pas likuidimit të Insig Dega Kosovë.

Shoqëria ka kërkuar prej Autoritetit mos-mbartjen në përllogaritjen dhe përfshirjen e humbjeve të mbartura të akumuluar ndërsa vite të aktivitetit të shoqërisë Insig-Kosovë, konkretisht në kapitale të veta të shoqërisë Insig-Shqipëri dhe detyrimeve ndaj Degës me arsyetimin se prej datës likuidimit 26 Prill 2019 shuhen të drejtat e aksionarëve, përveç të drejtës për pranimin e pasurisë nëse mbetet diçka pas kryerjes së kënaqshme të kërkesave që kanë përparësi ndaj aksionarëve dhe e drejta për të pranuar çdo pagesë neto të marrë nga të ardhurat e siguruesit dhe kryesisht e gjithë pasuria e tij, nëse likuidatori vërteton se sigurosi ka pasur vlerë neto pozitive në kohën e shitjes. Gjithashtu, Shoqëria Insig Shqipëri ka ndërpresë detyrimin me baza 3 mujore për periudhën 2017-2019, për shtesa kapitale në mjete monetare drejt Insig Kosovë dhe prej datës së likuidimit. Marrëdhënia me Degën Insig Kosovë mbetet ende e pasigurtë në deri në përfundimin e procesit të likuidimit.

Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (AMF) më anë të vendimit të Bordit numër 149 datë 27.10.2017 i Bordit parashtron masat administrative, ndër të tjera, ndalimin e transaksioneve me palet e lidhura dhe punonjësit dhe aksionaret si edhe hartimin e planit për përmirësimin e treguesve rregullatorë të Shoqërisë.

Në 13 mars 2019 Shoqëria realizoi shitjen e 100% të aksioneve të filialit Eurosigs AD, Shkup ndaj Grazer Eechselseitige Versicherung Aktiengesellschaft Herrengasse 18-20, 8010 Graz, Austria me numër identifikimi FN 37748m me çmimin 6.2 milione euro. Në marrëveshjen e shitjes së Shoqërisë së kontrolluara ishte parashikuar shuarja e detyrimit të huase subordinuete dhënë me parë Eurosigs AD për të cilën ka pasur kontestime me parë nga Autoriteti.

Impakti i Covid 19

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit potencialisht serioz që COVID - 19 paraqet për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë kanë ndërmarrë masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përfshirë shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu kanë udhëzuar punonjësit të qëndrojnë në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Aktiviteti i Shoqërisë, për periudhën Janar- Prill 2020 u mbyll me një rezultat Primesh të Shkruara prej 293,800 mije leke.

- Krahasuar me të njëjten periudhë të një viti më parë Janar-Prill 2019, rezultoni me një rënie prej 6% ose 18,804 mije Leke me pak.
- Krahasuar me planifikimin katër-mujor, rezultoni një realizim prej 82%/mosrealizim në masën 18% ose 63,788 mije Leke me pak

Luhatjet kryesore për Janar-Prill 2020, përshkruhen si më poshtë:

TPL - Rezultoi me një rënie prej 7% ose 14,535 mije Leke me pak, krahasuar me të njëjten periudhë të një viti më parë dhe me një masë realizimi të planit për katër mujorin prej 84%, mosrealizim në masën 16% ose 38,569 mije leke me pak se parashikimi.

Kartoni Jeshil: Ka pësuar një rënie prej 24% ose 10,123 mije Leke me pak krahasuar me Janar- Prill 2019 dhe me një masë realizimi të planit katër mujor prej 72 %, mosrealizim në masën 28% ose 12,325 mije Leke me pak se parashikimi.

Kasko: Ka pesuar një rënie prej 28%, ose 3,937 mijë Leke me pak krahasuar me Janar-Prill 2019, dhe me një realizim të planit për kater mujor prej 58%, mosrealizim në masën 42% ose 7,250 mijë leke me pak se parashikimi.

Kufitare: Ka pesuar një rënie prej 34% ose 1,921 mijë Leke me pak krahasuar me Janar-Prill 2019, dhe ka rezultuar me një plan të realizuar për kater mujorin në masën 56%, mosrealizim në masën 44% ose 2,977 mijë leke me pak se parashikimi.

Pasuria: Rezultoi me një rritje të primeve prej 60% ose 17,407 mijë leke me shumë duke e krahasuar me 2019, dhe me realizim të planit për kater mujorin prej 114%, tejkalim të tij prej 14% ose 5.554 mijë Leke me shumë se parashikimi pavarësisht vështirësive që ka dhënë situata e krijuar në vend në ecurine e biznesit.

Rënia e krijuar në disa prej produkteve të mesiperme dhe pothuajse në të gjitha degët vjen si rezultat i krizës që po kalon biznesi për shkak të pandemisë dhe izolimit. Me kalimin e pandemisë dhe lirimit të masave ndaj izolimit Shoqëria parashikon shkuarjen drejt stabilitet në ecurine e produkteve.

Drejtimi i Shoqërisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme nivelin e aftësisë paguese dhe mbulimin e detyrimeve nga sigurimi dhe beson se do të vazhdojë të mbështetet në mënyrë permanente nga aksionari i saj dhe për këtë arsye beson se veprimtaria e saj do të vazhdojë sipas parimit të vijimësisë.

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare për qëllime të veçanta.

3.1 Ndryshimet në politikat kontabël

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar. Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

3.1.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019

SNRF 16 "Qiratë"

Shoqëria ka miratuar prononcimet e reja të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive këtë vit, si më poshtë: SNRF 16 'Qiratë' SNRF 16 'Qiratë' zëvendëson SNK 17 'Qiratë' së bashku me tre interpretime (KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira', SIC 15' Qiraja Operative 'dhe SIC 27' Vlerësimi i thelbit të Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qiradhënies'). Miratimi i këtij Standardi të ri ka bërë që Shoqëria të njohë një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë në lidhje me të gjitha qiradhëniet e mëparshme, përveç atyre të identifikuar si me vlerë të ulët ose që kanë një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga data e aplikimit fillestar. Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive. Sipas kësaj qasjeje, Shoqëria ka matur detyrimin e qirasë në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke zbritur e duke përdorur normat në sektorin e qiradhënies për aktive të ngjashme dhe e drejta për të përdorur aktivin është njohur në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar nga shumat e çdo pagese të parapaguar ose të llogaritur të qirasë në lidhje me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar. Periudhat e mëparshme nuk janë riparaqitur. Për kontratat e vendosura në datën e aplikimit fillestar, Shoqëria ka zgjedhur të zbatojë përkufizimin e qirasë nga SNK 17 dhe KIRFN 4 dhe nuk ka zbatuar SNRF 16 për aplikimet që më parë nuk ishin identifikuar si qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 4.

Ekzistojnë përjashtime të njohjes për qiranë afatshkurtër dhe dhënien me qira të sendeve me vlerë të ulët.

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Shoqëria ka zgjedhur të mos përfshijë kostot fillestare direkte në matjen e aktivitetit të së drejtës së përdorimit për qiratë operative në ekzistencë në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, e cila është 1 janar 2019.

Në vend që të kryejë një rishikim të zhvlerësimit në aktivet e së drejtës së përdorimit në datën e aplikimit fillestar, Shoqëria është mbështetur në vlerësimin e saj historik nëse qirat kanë qenë menjëherë të mëdha përpara datës së aplikimit fillestar të SNRF 16. Në tranzicion, për qiradhëniet e llogaritura më parë si qira operative me një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj Shoqëria ka aplikuar përjashtime opsionale për të mos njohur aktivet të së drejtës së përdorimit, por për të llogaritur shpenzimet e qirasë në bazë të drejtpërdrejtë gjatë afatit të mbetur të qirasë. Për ato qira të klasifikuara më parë si qira financiare, aktivi i së drejtës së përdorimit dhe detyrimi i qirasë maten në datën e aplikimit fillestar në të njëjtat shuma si në SNK 17 menjëherë para datës së aplikimit fillestar. Në kalimin në SNRF 16, norma mesatare e ponderuar e huamarrjes në rritje e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 6 % p.a.

Kalimi në standardin e ri

Shoqëria planifikon të zbatojë fillimisht SNRF 16 më 1 janar 2019, duke përdorur një qasje të modifikuar në mënyrë retrospektive. Prandaj, efekti kumulativ i adoptimit të SNRF 16 do të njihet si një rregullim i shumave të çeljes.

Shoqëria planifikon të zbatojë lehtësi praktike për të trashëguar ndryshimin për përcaktimin e qirasë. Pra, do të aplikojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e lidhura para 1 janar 2019 dhe të identifikuar si qira në përputhje me SNK 17 dhe IFRIC 4

SNRF 16 "Qiratë" (vazhdim)

Më poshtë paraqitet një rakordim i balancave hapese për detyrimet e qirasë me 1 janar 2019 bazuar në detyrimet e qirasë operative më 31 dhjetor 2018.

Angazhimet totale të qirasë operative më 31 dhjetor 2018	34,934,929
Përjashtimet nga njohja:	
Qiratë e aktiveve me vlerë të ulët	
Qiratë me afat të mbetur të qirasë më pak se 12 muaj	(1,204,524)
Pagesat e qirave të panjohura	
Detyrimet e qirasë operative para zbritjes	33,730,405
Zbritur duke përdorur shkallën e huamarrjes në rritje	(2,099,542)
Detyrimet totale të qirasë të njohura sipas SNRF 16 më 1 Janar 2019	31,630,862

Aktivitetet e lidhura me të drejtën e përdorimit për qiratë e pasurive u matën në baza retrospektive sikur rregullat e reja të ishin zbatuar gjithnjë. Aktivitetet e tjera të së drejtës së përdorimit u matën në shumën e barabartë me detyrimin e qirasë, rregulluar nga shumën e çdo pagese të parapaguar ose qirase të akorduar në lidhje me atë qira të njohura në bilanc, më 31 dhjetor 2019

3.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që Shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët. Shoqëria planifikon ti aplikojë këto ndryshime në datat kur këto standarde do të jenë efektive.

Standardet që nuk priten të kene ndikim

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo efektive, Standarde dhe Ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Shoqëria përfshijnë:

- Ndryshimet në SNRF 9 "Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ" (në fuqi më 1 janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta" (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Këto ndryshime nuk priten të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shenimet shpjeguese nuk janë përgatitur.

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit njihen në të ardhura ose humbje. Produktet e sigurimit të Shoqërisë klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhet ose pushojnë së ekzistuari. Kontrata nën të cilat Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese), e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indeksat e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese apo indeksat e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

3.3 Njohja dhe matja e kontratave

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i skonton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Shoqëria ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqiptar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund t'i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto, e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale $1/365$, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata.

Megjithatë të gjitha produktet e Shoqërisë kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë. Primi i pafituar është ajo pjesë e primit, e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara, të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim dhe të ardhurat e shtyra të komisioneve përfaqësojnë pjesën e kostove të marrjes në sigurim të ndodhur dhe të ardhurat e marra që përputhen me rezervën e primit të pafituar. Ato përcaktohen si pjesë e kostove të blerjes dhe të ardhurës nga komisionet e risigurimit, të vendosura si përqindje në planin teknik të sigurimit dhe lidhen me periudhën midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës së shuarjes së kontratës së sigurimit. Kostot aktuale të marrjes në sigurim dhe të ardhurat nga komisionet e risigurimit njihen plotësisht si shpenzime dhe të ardhura të periudhës.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar sëbashku me rregullime të provigjonit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, dëmet e refuzuara gjithashtu njihen si pjesë e dëmeve të papaguara për një periudhë 2-vjecare. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjonuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme.

Provigjoni për dëmet e papaguara nuk skontohej.

Rregullimet për provigjionin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale. Nderkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi.

Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat Shoqëria ka regjistruar detyrimin përkatës në bazë të vlerësimeve të drejtimit.

3.4 Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruar dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL dhe pasurisë. Risigurime të tilla përfshijnë tejkalimin e humbjeve nga marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policë-mbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provigjionit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguresit dhe të arkëtueshmet nga Shoqëria risiguresë në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të veçanta, nëse ka.

Aktivët e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

3.5 Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve

Në çdo datë raportimi Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë të rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provigjoneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të jashtëme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë vlerësimet aktuale të fluksve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skanton këto flukse monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brenda një viti.

Për më tepër, Shoqëria kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provigjoneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analizë kryhet në mënyrë të veçantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës.

3.6 Instrumentet Financiare

i) Njohja

Shoqëria fillimisht njihet si kreditë dhe paratë, të arkëtueshme dhe huatë në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e transaksionit në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

ii) Regjistrimi

Shoqëria regjistron një aktiv financiar nëse humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Shoqëria njihet si aktiv ose detyrim i veçantë.

Shoqëria regjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

iii) Netimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbyllë aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

iv) Matja e koston së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

v) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumentave financiarë në tregjet aktive. Për të gjithë instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregjet aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

vi) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në çdo datë raportimi Shoqëria vlerëson nëse ka evidenca objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivitetet financiare pësojnë rënie në vlerë kur evidenca objektive dëshmon që një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivitetit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e ardhshme monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme.

Shoqëria merr në konsideratë evidenca për rënien në vlerë të aktiveve financiare specifike ose në grup. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme testohen veçmas për humbjen e mundshme në vlerë. Të gjitha aktivet e rëndësishme që nuk konsiderohet të kenë rënë në vlerë vlerësohen më pas kolektivisht për ndonjë rënie në vlerë që ka ndodhur por nuk është identifikuar. Aktivitetet që individualisht nuk janë të rëndësishme grupohen dhe vlerësohen së bashku për rënie në vlerë me aktive me karakteristika të ngjashme (të mbajtura me kosto të amortizuar).

(të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek, përveç kur është shprehur ndryshe)

Si evidencë objektive për rënie të mundshme në vlerë të aktiveve mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Shoqëria me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar; tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që ndikojnë në përkeqësimin e grupit të aktiveve.

3.7 Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes.

3.8 Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet fillestar më të vogël se tre muaj klasifikohen si ekuivalentë të mjeteve monetare, ato me maturitet mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat.

3.9 Letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime në borxh, të cilat Shoqëria ka për qëllim dhe aftësinë t'i mbaje deri në maturim dhe klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat kanë për qëllim të mbahen deri në maturim maten me kosto të amortizuar, minus provizionet për rënien nga vlera. Kostoe amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo prim apo zbritje gjatë blerjes.

3.10 Llogaritë të arkëtueshme sigurimi dhe të tjera

Llogaritë të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë të mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

Të tjera

Aktivitetet e tjera financiare jo derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3.14.

3.11 Njohja e të ardhurave

i) Primet

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 3.3.

ii) Të ardhura nga qiraja

E ardhura nga qiraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara.

3.12 Kostot e marrjes në sigurim dhe trajtimit të dëmeve

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin prej blerjes së kontratave të reja të sigurimit, përfshirë këtu kosto direkte si komisionet e blerjes dhe kostot e përpilimit të dokumentit të sigurimit, por edhe shpenzime të pjesshme administrative të lidhura me procesimin e propozimit dhe lëshimin e policës.

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Kostot direkte të marrjes në sigurim shtyhen përgjatë kohëzgjatjes së policës përmes një metode konsistente me llogaritjen e provigjonit të primit të pafituar dhe paraqiten bruto nga detyrimi përkatës i sigurimit, si një aktiv. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim amortizohen sistematikisht përgjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk rimerret konsiderohet shpenzim.

3.13 Shpenzimet

i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

ii) Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë të ardhura pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit ligjor minimal për pensionet në kuadër të juridiksionit respektiv dhe planit të kontributeve të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë në planin e pensionit i ngarkohen pasqyrës së humbje fitimeve kur ato ndodhin.

3.14 Të ardhura dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto. Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.15 Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Ndërtesat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostoja përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka patur), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribuueshme që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme. Kur pjesët e një aktivi kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjes.

Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii) Kosto të mëtejshme

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritët që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

iii) Zhvlerësimi

Toka, parapagimet dhe aktivet në process nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndërtesave dhe përmirësimeve infrastrukturore realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktivit, ndërsa zhvlerësimi i aktiveve të tjera realizohet përmes metodës së vlerës së mbetur aplikuar mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve. Normat e vlerësuar të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa dhe përmirësime të qiramarrjeve	5 %
Paisje zyre	20 %
Mjete motorike	20 %
Kompjutera dhe programe kompjuterike	25 %

Vlera e mbetur, nëse është e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qiramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qirasë.

3.16 Aktive të patrupezuara

Aktivët e patrupezuara të blera nga Shoqëria, të cilat kanë jetë të dobishme të pafundme, maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënit në vlerë të akumuluar. Norma e zhvlerësimit është 25% me metodën e vlerës së mbetur.

i) Shpenzimet e mëvonshme

Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin specifik me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të gjeneruar nga brenda dhe të markave, njihen në fitimin ose humbjen e vitit kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas metodës së vlerës së mbetur, duke u bazuar në kërkesat ligjore për normat e zhvlerësimit të aktiveve të patrupezuara, një muaj pas blerjes së aktivit.

Jeta e dobishme e aktiveve rivlerësohet, dhe rregullohet nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Shtesat dhe humbjet nga dalja jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e mbartur dhe përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.17 Investime në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme

Investimet në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme fillimisht maten me kosto historike, përfshirë edhe kostot e trasaksionit. Menjëherë pas njohjes fillestare, investimet në pasuri të paluajtshme maten me kosto historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi në datën e raportimit. Investimet në ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme çregjistrohen në rastin kur ato nxirren nga përdorimi ose kur investimi në pasuri të nuk përdoret më dhe nuk priten më të ardhura nga nxjerrja e tij apo përdorimi. Zhvlerësimi në ndërtesat e investueshme përllogariten duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

3.18 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi ose njësie e tij e gjenerimit të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përlogaritjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë para efektit të taksës, e cila reflekton vlerësimet momentale të tregut për vlerën në kohë të parasë si edhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbja nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme rishikohet në çdo datë raportimi nëse ka tregues që humbja është pakësuar ose nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi rikthehet nëse ka patur një ndryshim në vlerësimin e përdorur për të përcaktuar vlerën e realizueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet vetëm në masën, me të cilën vlera e mbartur e aktivit nuk do të tejkalonte vlerën e mbartur të tij e cila do të ishte përcaktuar si vlera neto pas amortizimit nëse nuk do ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

3.19 Të drejta përdorimi të aktiveve

Shoqëria si qiramarrëse për çdo kontratë të re të lidhur me ose pas 01 janar 2019, konsideron nëse është një kontratë, apo përmban një qira. Një qira përcaktohet si "një kontratë, ose pjesë e një kontrate, që përcjell të drejtën për të përdorur një aktiv (aktivin themelor) për një periudhë kohe në këmbim të pagesës". Për të zbatuar këtë përkufizim, shoqëria vlerëson nëse kontrata përmbush tre vlerësime kryesore, të cilat janë:

- kontrata përmban një aktiv të identifikuar, i cili ose përcaktohet në mënyrë të qartë në kontratë ose specifikohet në mënyrë të qartë duke u identifikuar në kohën kur aktivi është vënë në dispozicion të shoqërisë
- Shoqëria ka të drejtë të sigurojë në tërësi të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit, duke marrë parasysh të drejtat e tij në qëllimin e caktuar të kontratës
- Shoqëria ka të drejtë të përcaktojë përdorimin e aktivit të identifikuar gjatë gjithë periudhës së përdorimit. Shoqëria vlerëson nëse ka të drejtë të përcaktojë 'si dhe për çfarë qëllimi' aktivi përdoret gjatë gjithë periudhës së përdorimit.

Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës

Në datën e fillimit të qirasë, shoqëria njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim të qirasë në pasqyrat financiare. Aktivet e së drejtës së përdorimit maten me koston, e cila përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e bërë nga shoqëria, një vlerësim i çdo kostoje për çmontimin dhe heqjen e aktivit në fund të qirasë, dhe çdo pagesë e qirasë bërë përpara datës së fillimit të qirasë (neto e çdo incentivi të marrë).

Shoqëria zhvlerëson aktivet e të së drejtës së përdorimit në bazë të drejtpërdrejtë nga data e fillimit të qirasë deri në fund të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit ose mbarimit të afatit të qirasë. Shoqëria gjithashtu vlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit për zhvlerësim kur ekzistojnë tregues të tillë.

Matja dhe njohja e qirave si qiramarrës (vazhdim)

Humbje neto e vitit dega Kosove 31 mars 2019	(9,604,775)	-
Fitim/(humbje) neto e vitit të Degës Insig Sh.a Kosove 2018	-	(63,986,313)
Gjendja me 31 dhjetor	(528,217,300)	(518,612,525)

17. Pjesëmarrje në shoqëri të kontrolluara

Më 8 mars 2003, Shoqëria filloi të operojë edhe në territorin Republikës të Maqedonisë nëpërmjet INSIG AD, Shkup e cila pas privatizimit të Insig Sh.a, Shqipëri ndyshoi emrin në Eurosig AD, Shkup (“Shoqëri e Kontrolluar”). Eurosig AD, Shkup është 100% në pronësi të INSIG Sh.a. Më 31 dhjetor 2018, kapitali aksionar i Shoqërisë së kontrolluar përbëhet prej 3.000 aksione të zakonshme (2017: 3,000 aksione) me një vlerë nominale prej 1,000 Euro për aksion. Në 13 mars 2019 me Shoqëria, me anë të kontratës së shitblerjes së aksioneve të po kësaj date, realizoi shitjen e 100% të aksioneve të filialit Eurosig AD, Shkup ndaj Grazer Eechselseitige Versicherung Aktiengesellschaft Herrengasse 18-20, 8010 Graz, Austria me numër identifikimi FN 37748m. Me cmim bruto 6,258,730 Eur. Cmimi bruto i shitjes reduktohet me vlerën 1,858,730 euro për rritjen e kapitalit të Shoqërisë së kontrolluar sipas termave të kësaj kontrate. Kontrata e shitblerjes së aksioneve përfshin edhe kthimi i huase subordinuese dhënë me parë Eurosig AD.

Fitimi i realizuar shitjes së Shoqërisë së Kontrolluar është llogaritur si më poshtë:

	Vlera në Euro	Vlera në Lekë
Cmimi bruto i shitjes sipas kontratës	6,258,730	781,277,266
Rritje Kapitali në Shoqërine e kontrolluar	1,858,730	232,025,266
Cmimi neto i shitjes	4,400,000	549,252,000
Vlera kontabel e Investimit me kosto		(380,245,000)
Fitimi i realizuar		169,007,000

Cmimi neto i shitjes së Investimit prej 4,400,000 Euro është arkëtuar në llogarinë e Shoqërisë pranë Raiffeisen Bank.

18. Hua subordinuese në Shoqëri të kontrolluara

Më 2 nëntor 2018, Shoqëria lidhi një marreveshje për një hua subordinuese të dhënë ndaj Shoqërisë së kontrolluar Eurosiga AD, Shkup për shumën prej 981,672 Euro, me maturitet 10 vjet dhe normë interesi 4% ne vit. Në kontratën e shit-blerjes së aksioneve, datë 13 mars 2019 përfshihej edhe kthimi i huasë subordinuese në vlerën 1 milion Euro (981,672 Euro plus interesa dhe kosto) dhënë me parë Eurosiga AD. Shumat për shlyerjen e huasë janë arkëtuar në llogarinë e Shoqërisë pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

19. Detyrimet e sigurimit për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja më 1 janar	765,811,306	834,317,821
Rimarrje nga risigurimet	(288,626,036)	(201,193,875)
Zbritet rezerva e demeve neto të aktivitetit të jetes	-	-
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	477,185,270	633,123,946
Dëme të ndodhura	183,740,547	195,940,624
Dëme të paguara	(291,915,899)	(351,879,299)
Detyrime neto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve	369,009,918	477,185,270
Rimarrje nga risigurimet	184,304,505	288,626,036
Detyrime bruto të sigurimeve për humbje dhe rregullime të humbjeve më 31 dhjetor	553,314,423	765,811,306

Ndryshimi bruto në rezervat e sigurimit të demeve përbëhet nga ndryshimi bruto në rezervat për dëmet e raportuara por ende të pashlyera dhe në dëmet e ndodhura por ende të paraportuara.

Dëmet e paguara sipas produkteve të sigurimit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete motorike	714,907,008	814,155,522
Prona	151,083,316	130,818,152
Shëndeti	5,998,673	3,685,875
Totali	871,988,997	948,659,548

20. Rezerva për primet e pafituara

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja më 1 janar	510,224,108	551,652,540
Prime të shkruara gjatë vitit	1,129,175,075	1,093,464,534
Minus: prime të fituara gjatë vitit	(1,073,506,143)	(1,134,892,966)
Gjendja më 31 dhjetor	565,893,040	510,224,108

Rezervat e primeve të pafituara nga produktet e sigurimit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete motorike	463,179,966	438,175,507
Prona	86,557,284	66,771,366
Shëndeti	6,165,792	5,277,235
Totali	565,893,042	510,224,108

21. Të pagueshme ndaj risiguruesve

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
MAI Reinsurance Brokers	2,447,256	2,361,576
Marsh LTD	2,051,581	-
Willis LTD	-	5,399,743
Aon UK Limited	-	1,139,775
SIGAL Uniq Group Austria	4,413,514	1,351,696
AVUS GREECE	-	62,327
Other Reinsurance Payables	61,611	-
Total	8,973,962	10,315,117

22. Detyrimet e qirasë

Detyrimet nga kontratat e qiramarrjes

Detyrimet nga kontratat e qiramarrjes sipas SNRF 16 sipas maturitetit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019
Detyrime afatshkurtra	897,484
Detyrime afatgjata	12,933,705
Total	13,831,189

Detyrimet nga kontratat e qiramarrjes lidhen me kontratat e qirasë të klasifikuara si qira financiare të njohura në kontabilitet sipas SNRF 16. Shoqëria ka marre me qera ambjentet ku zhvillon aktivitetin kryesor me afat maksimale nga 1 deri 3 vite. Pagesat minimale të qirasë në të ardhmen si më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

31 dhjetor 2019	Brenda vitit	1 deri ne 3 vite	Pas 3 vitesh	Totali
Kestet e qirase	19,080,338	14,650,067	-	33,730,405
Shpenzimet	(1,280,723)	(818,820)	-	(2,099,543)
Totali	17,799,615	13,831,247	-	31,630,862

E drejta e përdorimit të aktiveve dhe detyrimi i qirase më 31 dhjetor 2019, analizohen si më poshtë:

	E drejta e përdorimit të asetit		Detyrimi për Qiranë	
	Ndërtesa	Total	Ndërtesa	Total
Gjendja më 1 janar 2019	28,864,718	28,864,718	28,864,718	28,864,718
Shtesa	2,766,146	2,766,146	2,766,087	2,766,087
Shpenzime Amortizimi	(20,393,442)	(20,393,442)	-	-
Shpenzime Interesi	(1,280,722)	(1,280,722)	-	-
Pagesa	-	-	(17,799,616)	(17,799,616)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	9,956,700	9,956,700	13,831,189	13,831,189

23. Hua Bankare

Gjatë vitit 2017, Shoqëria ka lidhur një marreveshje huaje bankare për shumën prej 202,500,000 lekë me 'Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a' (BBSH). Huaja ka maturitet 7 vjet dhe mbart interes me normë 5,973% + bono thesari minimumi 8% ne vit. Shoqëria ka vendosur si kolateral një toke dhe ndertese të blere në shumën prej 2,500,000 Euro sipas kontratës nr. 2098, date 03.05.2017.

24. Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera

Detyrime të tjera përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të pagueshme ndaj furnitorëve	33,161,367	17,622,840
Të pagueshme ndaj shtetit	1,056,795	150,748
Të pagueshme ndaj personelit	7,518,697	7,760,804
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,129,648	2,521,766
Komisione agentësh	11,257,251	35,552,735
Sigurime shoqërore për rimbursim dëmi	15,274,833	15,274,833
Detyrime për bashkësigurime	-	2,180,348
Të tjera të pagueshme	24,002,225	28,535,787
Totali	94,400,816	109,599,861

25. Provigjione të tjera

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Në fillim të vitit	360,860	360,860
Të rimarra gjatë vitit	14,711,836	-
Totali	15,072,696	360,860

Provigjione të tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë krijuar për të mbuluar kosto të mundshme ligjore në lidhje me përfitimet e punonjësve për të cilët Shoqëria ka përfunduar marrëdhënien e punës.

26. Kapitali Aksioner

Kapitali i nënshkruar është i ndarë në 1,083 aksione (2016: 1,083 aksione) ku secila prej tyre ka një vlerë nominale prej Leke 600,18 (2017: Leke 600,18 mijë). Struktura e kapitalit aksioner më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kapitali aksionar më 1 janar	650,000,000	650,000,000
Kapitali aksionar më 31 dhjetor	650,000,000	650,000,000

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	%	Në LEK	%	Në LEK
Eurosig sh.a	100.00%	650,000,000	100.00%	650,000,000
Total	100.00%	650,000,000	100.00%	650,000,000

27. Rezerva e rivlerësimit

Rezerva e rivlerësimit për ndertesa dhe pajisje është krijuar më 1 Janar 1998, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 194 më 20 Mars 1998 për rivlerësimin e aktiveve të trupëzuara të Shoqërisë.

Gjatë 2013 Shoqëria ka rivlerësuar një pjesë të aktiveve të qëndrueshme duke rezultuar në një vlerë të shtuar prej 48,244,165 Leke. Gjatë vitit 2017 janë rivlerësuar një pjesë e ndertesave duke rezultuar me një vlerë rivlerësimi 31,766,012 leke (referoju shenimit 14).

Ndertesat, prone e INSIG sh.a. më 31.12.2017, janë rivlerësuar në rritje për 31,766,012 Leke. 85% e shumës së rivlerësimit në vlerën 27,001,110 Leke është evidentuar në rritje të rezervës së rivlerësimit. Leke është evidentuar si detyrim tatimor i shtyre.

Gjithashtu në vitin 2018 është bërë shitja e një ndërtese në Lushnje si dhe rivlerësimi i Godinës së zyrave qendrore nga ekspert të vlerësimit të pasurive të paluajtshme.

Ndërtesa në Lushnjë, është rivlerësuar në nëntor të vitit 2017 me një shume totale rreth 24.253.500 Leke. Ndryshimi i vlerës së kësaj ndërtese në vlerën prej 22.250.047 Leke është paraqitur si rritje në rezervën e vitit 2017. Kjo ndërtesë është shitur më 03.01.2018 kundrejt Eurosig sh.a me një vlerë 705.169 Leke. Në momentin e transaksionit të shitjes, është ulur edhe rezerva e rivlerësimit për aktivin me një shumë prej 18.912.540 Leke.

Godina, qendrore e INSIG sh.a. më 28.09.2018, është rivlerësuar në rritje me një shumë prej 3.500.000 Euro, duke rritur kështu vlerën e saj me një shumë prej 126,949,548 Lekë (rritje rreth 38% e vlerës)

Në 2019 nuk ka pasur rivlerësim ndërtesash ose paisjesh.

28. Rezerva për parandalim dëmsh

Rezerva për parandalimin e dëmeve është krijuar përpara vitit 1998 nga urdhri i Këshillit Mbikqyrës mbi fitimin neto të atyre pasqyrave financiare që paraqiten sipas standarteve kombëtare e cila parashikon pagesën e çdo dëmi të paparashikuar gjatë aktivitetit të Shoqërisë. Më 31 dhjetor 2019 nuk ka patur asnjë lëvizje të rezervës.

29. Rezerva të tjera

Rezervat e tjera janë krijuar prej fitimeve të mbajtura të viteve të mëparshme bazuar në statutin e Shoqërisë. Këto rezerva mund të përdoren vetëm me vendimin e aksionerëve.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Rezerva për riskun e sigurimit	387,049,126	387,049,126
Rezerva e përgjithshme	149,357,817	149,357,817
Rezerva për sisteme online	25,757,490	25,757,490
Rezerva për mbulimin e humbjeve potenciale	488,446,903	488,446,903
Totali	1,050,611,336	1,050,611,336

Rezervat e përgjithshme janë krijuar prej fitimit të mbartur të viteve të kaluara bazuar në rregulloren e shoqërisë pa një destinacion të caktuar.

Rezervat e riskut të sigurimit janë të krijuara bazuar në ligjin Shqiptar të Sigurimit, me një vlerë sa 1/3 e fitimit korrent, përveçse kur fitimi korrent përdoret për të mbuluar humbjet e akumuluar. Kjo rezervë mund të rritet në një nivel jo më të ulët se 30% e primeve mesatare të nënshkruara në dy vitet e fundit. Gjatë vitit 2017, nuk ka patur ndryshime në rezervën e riskut të sigurimeve prej 387,049 mijë Lekë.

Rezerva e Sistemit online është krijuar me vendimin e asamblesë aksionere.

Rezerva për katastrofë u krijua më 31 dhjetor 2001 nga fitimet e mbartura të Shoqërisë. Kjo rezervë u krijua për të mbuluar humbjet e mundshme në të ardhmen si pasojë e fenomeneve shkatërrues. Pas një rishikimi të brendshëm të kuadrit rregullator, Këshilli Mbikqyrës miratoi rialokimin e rezervës së katastrofës në rezerva të tjera, me emërtimin "Rezerva për mbulimin e humbjeve të mundshme".

30. Prime të nënshkruara bruto

Primet bruto të sigurimit dhe të risigurimit sipas produkteve janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Motorike (MTPL)	942,223,814	773,572,596
Prona	164,236,869	123,275,503
Shëndetësore	22,714,392	196,616,435
Totali	1,129,175,075	1,093,464,534

31. Prime të ceduara të risiguresit

Primet e ceduara të risiguresit sipas produkteve të sigurimit detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Motorike (MTPL)	13,006,806	10,179,126
Prona	42,624,672	46,474,458
Shëndetësore	10,210,462	14,537,494
Totali	65,841,940	71,191,078

32. Të ardhura të tjera

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shërbimet	1,006,697	128,681
Komisione risigurimi	1,289,556	775,800
Fitimi neto nga shitje pasuri të paluajtshme	-	-
Te ardhura nga revokim kontrate	70,073	12,066,427
Te ardhura nga padite e regresit për demet e fondit të kompesimit BSH	3,650,858	4,765,346
Të tjera	6,358,140	6,002,779
Totali	12,375,323	23,739,033

33. Shpenzimet e marrjes në sigurim

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Komisione agentëve	307,675,568	269,192,838
Shpenzime të tjera të marrjes në sigurim	4,079,411	3,902,777
Blerje policash	1,136,303	1,209,048
Ndryshime në kostot e marra në sigurim	18,422,350	35,670,194
Totali	331,313,633	309,974,857

34. Shpenzime Administrative

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Pagat	124,957,469	138,244,677
Qira	5,362,622	30,060,528
Kontributi për buxhetin e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve	5,330,768	6,902,572
Kontributi për autoritetin e mbikqyrjes	15,814,487	13,008,664
Kontribut për Fondin e Kompensimit të Byrosë së Sigurimeve	27,049,162	103,337,239
Kontribut për shoqatën e siguresve	2,891,250	1,085,294
Reklama	-	8,154,403
Penalitete	3,650,937	14,360,384
Mirëmbajtje dhe riparime	3,912,361	7,028,239
Amortizimi	48,476,746	29,118,521
Posta, telefona	3,803,458	3,780,681
Mirëmbajtje pajisje dhe rrjeti IT	5,335,075	962,217
Taksa lokale	5,070,032	5,651,145
Udhëtime	245,180	2,912,628
Printime dhe kancelari	4,829,218	2,532,460
Dhurime	2,422,151	1,540,026
Shpenzime karburanti	5,688,291	5,219,249
Zhvleresime inventari	-	156,281
Shpenzime për shërbime bankare	4,547,381	3,009,407
Nxjerrje jashtë perdorimit	-	2,635,925
Shpenzime ndërmjetësimi	146,124,000	-
Të tjera	28,870,124	19,559,319
Totali	444,380,711	399,259,859

Shpenzime ndërmjetësimi përfshijnë 2 shuma të paguara në vlerat 600 mijë euro secila, në bazë të kontratave të ndërmjetësimi, datë 19 shkurt 2019, kundrejt Z.Samir Mane dhe Z.Shefqet Kastrati për shërbimin e ndërmjetësimi të kontratës së shit-blerjes së aksioneve të Shoqërisë së Kontrolluar Eurosig AD.

Shpenzimet e tjera të sigurimit përbëhen nga pagesat që kryhen përkundrejt byrosë së sigurimeve në lidhje me dëme të shkaktuara nga individë të pasiguruar.

35. Të ardhura financiare

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga bono thesari dhe depozitat	6,261,289	5,323,119
Të ardhura nga llogaritë bankare	33	210
Total	6,261,321	5,323,329

36. Fitim nga kursi i këmbimit, neto

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Humbje nga kursi i këmbimit, bruto	7,103,750	33,467,485
Fitime nga kursi i këmbimit, bruto	(24,526,741)	(67,277,096)
Totali	(17,422,991)	(33,809,611)

37. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin

Tatim fitimi në Shqipëri është në normën 15% (2017: 15%) e të ardhurave të taksueshme.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatimi aktual mbi fitimin	17,878,934	8,041,123

Më poshtë është paraqitur rakordimi midis tatim fitimit të përlogaritur me normën e aplikueshme tatimore me shpenzimin e tatim fitimit.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhurat	1,054,077,244	1,074,697,756
Shpenzimet	952,682,597	1,034,296,182
Shpenzimet e pazbritshme	17,798,248	13,205,911
gjat, kamat-vonesat dhe kushtet e tjera penale	2,442,464	14,512,487
krijimi ose rritja e rezervave e fondeve të tjera	15,326,784	(4,566,629)
shpenzimet e përfaqesimit, pritje përcjellje	29,000	102,065
amortizim nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	3,157,988
Fitim i tatueshem neto	119,192,894	53,607,485
Norma e tatim fitimit në %	15%	15%
Tatim fitimi me shkallën tatimore standarte	17,878,934	8,041,123

Drejtimi beson se llogaritja e tatimit mbi provigjionin e fitimit është e përshtatshme duke marrë parasysh pasigurinë e mjedisit ligjor shqiptar dhe legjislacionin ekzistues në fuqi dhe çdo auditim tatimor i ardhshëm nuk do të ketë një efekt domethënës në pozicionin financiar të Shoqërisë, në rezultatet e operacioneve apo në flukset e parasë. Sidoqoftë, bazuar dhe në natyrën e ligjit për tatim fitimin, praktikën e lidhura dhe udhëzimet nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi që pozicioni ligjor i tatimit aktual do të qëndrojë i pakundërshtueshëm nga autoritetet tatimore.

38. Transaksione me palët e lidhura

Sipas statutit të Shoqërisë, organi më i lartë është asambleja e përgjithshme e Shoqërisë. Shoqëria ka një sistem të dyfishtë qeverisjeje të Bordit të Mbikëqyrës dhe Drejtimit. Shoqëria kryen transaksionet me aksionerët e tij gjatë rrjedhës normale të biznesit.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<i>Shpenzime</i>		
Shperblime te Bordit Mbikeqyres	35,294	757,528
Paga Administratori	6,247,200	6,022,044
Totali i shpenzimeve	6,282,494	6,779,572
<i>Te arketueshme</i>		
Hua ndaj Eurosig sh.a	643,436,599	366,329,023
Të arketueshme nga Eurosig sh.a	36,716,027	36,716,027
Të arketueshme nga bashkësigurimi me Eurosig sh.a	20,797,585	20,840,448
Marëdhënie me Degën Insig Sh.a Kosovë	-	121,157,958
Pjesmarje në shoqëri të kontrolluara Insig Maqedoni	-	380,245,000
Total i të arkëtueshmeve	700,950,211	925,288,456
<i>Të pagueshme</i>		
Te pagueshme nga shoqëri të kontrolluara Insig Maqedoni	-	4,604,829
Marëdhënie me Degën Insig Sh.a Kosovë	528,217,300	518,612,525
Të pagueshme ndaj Eurosig Sh.a	-	-
	528,217,300	523,217,354

39. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Përgjatë rrjedhës të zakonshëm të biznesit, Shoqëria është përfshirë në pretendime dhe veprime ligjore të ndryshme. Sipas opinionit të menaxhimit, zgjidhja përfundimtare e këtyre çështjeve nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë apo ndryshimin e aktiveve neto. Çështjet ligjore janë të zakonshme në të cilat paditësit nuk bien dakord me vlerësimin e dëmit të bërë nga Shoqëria. Menaxhimi i vlerëson pretendimet duke përdorur ekspertizë të jashtme dhe të brendshme përfshirë këtu edhe konsulencën ligjore. Menaxhimi beson se këto vlerësime janë të përshtatshme por megjithatë pranon se rezultati final mund të jetë një shumë më e madhe ose më e vogël se sa ajo e parashikuar.

Ndryshime në rregullat qeverisës në segmentet e biznesit

Biznesi i sigurimit është subjekt i mbikqyrjes në zhvillim dhe i mbikqyrjes të plotë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Qëllimi parësor i këtyre marrëdhënieve është që të mbrojnë mbajtësit e policave. Ndryshimet në ligjet ekzistuese të sigurimit mund të kenë efekt në mënyrën që Shoqëria krijon biznesin dhe produktet e ofruara. Për më tepër, ligjet apo rregullat e sigurimit e adoptuara dhe të amenduara me kohë mund të jenë më parandalues ose mund të rezultojnë në kosto më të larta se kërkesat aktuale.

40. Ngjarjet pas periudhës raportuese

Gjatë fillimit të vitit 2020, globalisht u përhap pandemia e COVID -19. Në Shqipëri, impaktin masiv e pati prej muajit mars 2020, kur qeveria morri masa drastike duke pezulluar gjithë aktivitetet të cilat nuk ishin jetike. Shoqëria është në procesin e vlerësimit dhe marrjes së masave për parandalimin e ndikimeve negative në aktivitetet e saj. Megjithatë nuk është ende në gjendje të vlerësojë impaktin financiar të situatës në vazhdim mbi aktivitetet e saj.

Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare.

ANEKSE SHOQËRUESE SUPLEMENTARE

Aneke Shtesë

a. Aktivët e lejuara në mbulim të provigjioneve teknike

Bazuar në Nenin 97, të Ligjit nr.52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Rregulloren Nr 19, datë 28.04.2015 "Për aktivët në mbulim të provigjioneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve", e ndryshuar, Shoqëria ka përllogaritur aktivët e saj në mbulim të provigjioneve teknike si më poshtë:

	Limitet e investimeve në %	Shumat që kalojnë limitet e investimeve
Toka dhe Ndertesë	30% për çdo ndertese	360,497,833
Hua të pasiguruar dhe të siguruar me garanci hipotekore	10%	1,288,616,807
Depozita me afat (me përjashtim të fondit të garancise)	Pa kufizim	103,832,055
Tituj të tregtuar në tregjet e parregulluar	10%	-
Shuma të policembajtesve dhe ndermjetesve që rrjedhin nga veprimtaria siguruese/risiguruese të drejtpërdrejta	20%	-
Shpenzime të marrjes në siguri të shtyra	15%	160,663,722
Tituj të tregtuar në tregjet e rregulluar	Pa kufizim	
Pjesa e risigurimit në provigjionet teknike klasifikimi mbi BBB	Pa kufizim	200,763,646
Depozita në shoqëri ceduese	20%	608,850
Të arketueshme nga sigurimet dhe të tjera të arketueshme me pak se 90 ditë	E limituar, deri 20% e UPR	120,357,750
Mjete monetare dhe ekuivalentet	E limituar, deri 3% e PT	2,623,646
Investime në aktive fikse (të ndryshme nga toka dhe ndertesat)	E limituar, deri 5% e PT	-
Aktive të tjera	E limituar, deri 5% e PT	63,106,620
Investime të tjera në depozita garancie të kartonit jeshil në BSHS	Pa kufizim	35,994,110
Interesi i llogaritur	E limituar, deri 5% e PT	3,294,343
Totali i aktiveve të përshtatshme në mbulim të provigjioneve teknike		1,470,370,420
Totali provigjioneve teknike bruto më 31 dhjetor 2019		1,437,882,037
Tëprica (+)/deficit (-) i aktiveve në mbulim të provigjioneve teknike		32,488,383
Shkalla e mbulimit të humbjeve		102.26%

b. Aftësia paguese mbi bazë kapitali

Bazuar ne Nenin 79,pika3 të Ligjit nr.52,datë 22.0.5.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe Rregulloren Nr 87, datë 27.06.2016 "Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit të shoqërive të sigurimit":

<i>Niveli aktual i aftësisë paguese:</i>	31 dhjetor 2019
Kapitali bazë dhe kapitali shtesë	2,546,926,711
Kapitali aksionar i paguar	650,000,000
Rezerva e sigurisë	1,383,801,538
Fitim/Humbja e akumuluar	513,125,173
Elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit	1,612,616,527
Kapitali (Aftësia paguese):	934,310,184
Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	298,197,617
Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (C-F)	564,310,184

RAPORTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM (Përmbledhje)

Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për vitin 2019.

Auditimi i brendshëm për vitin 2019 në shoqërinë e sigurimeve “Insig sha” është zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 153, datë 23.12.2014, “Për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit”, rregullores nr. 11, datë 24.03.2015, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shoqërisë Insig sha” dhe “Planit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019” të shoqërisë, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 15, date 13/12/2018.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në vazhdimësi, gjatë gjithë vitit 2019, ka kontrolluar dhe audituar ecurinë e punës në fushat kryesore të veprimtarisë së Insig. Pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Raporti Vjetor i Auditimit të Brendshëm 2019, u shqyrtua dhe miratua dhe nga Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr. 2, datë 20.05.2020. Raporti u është shpërndarë për njohje dhe zbatim të gjitha strukturave të Insig.

Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe mbi përputhshmërinë me rregullat e administrimit të rrezikut.

Në përgjithësi baza rregullative e hartuar nga kompania është në përputhje me ligjet dhe rregulloret pëkatëse të hartuara nga AMF. Pavarësisht kësaj, gjatë auditimeve është konstatuar nevoja e rishikimit të disa akteve të brendshme me qëllim përditësimin e tyre dhe përshtatjen me kushtet aktuale në të cilat operon kompania.

Manaxhimi i Riskut harton çdo vit “Raportin e Vetëvlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pagueuse”, në të cilin identifikohen dhe vlerësohen nivelet e risqeve, ndaj të cilave është e ekspozuar shoqëria, si dhe jepen rekomandimet e nevojshme për menaxhimin e risqeve, me qëllim reduktimin e risqeve të identifikuar, si dhe parandalimin e ekspozimit ndaj risqeve në të ardhmen.

Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda departamenteve dhe njësive të audituara, si në drejtim të hartimit të procedurave, menaxhimit të shpenzimeve dhe administrimit të dokumentacionit. Janë kryer investigime, verifikime, vlerësime dhe kontrole paraprake të dokumentacionit justifikues. Ky sistem me procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulojnë dhe menaxhojnë departamentet dhe njësitë e audituara.

Me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave për zgjidhjen e tyre në kohë është e nevojshme që të rritet shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturave të brendshme të kompanisë. Problematikat e konstatuara nga çdo strukturë duhet të raportohen në mënyrë të dokumentuar dhe të diskutohen në takime të përbashkëta ndërmjet strukturave në mënyrë që të përcaktohen dhe zgjidhjet më të mira të mundshme. Si rezultat i kësaj shmanget risku që kontrollet e brendshme të jenë jo efektive.

Efektiviteti i punës së degëve dhe departamenteve përkatëse për realizimin e shitjeve.

Gjatë vitit 2019 kompania ka pasur rritje të shitjeve në masën rreth 3%, por krahasuar me objektivat e kompanisë pothuajse shumica e degëve rezultojnë me mosrealizim të tyre. Mosrealizimi i shitjeve në nivel kompanie krahasuar me buxhetin është në masën 7%. Volumi i primeve të Sigurimeve të Detyrueshme është rritur me 3% krahasuar me 2018-ën, ndërsa volumi i primeve të Sigurimeve Vullnetare është rritur me 7%. Raporti Sigurime të Detyrueshme / Sigurime Vullnetare për vitin 2019 është 83% me 17% kundrejt raportit 86% me 14% të vitit 2018.

Nëse i referohemi realizimit të treguesve sipas degëve rezulton se shumica e degëve nuk kanë realizuar objektivat e vendosura, si dhe përgjithësisht fokusi i tyre është në produktet motorrike. Planet dhe objektivat janë të përcaktuara nga qendra deri në nivel dege dhe për operatorët e shitjes ka nivel fiks plani të përcaktuar. Shpërndarja e planit të degës sipas agjentëve dhe specialistëve të tjerë të shitjes bëhet nga drejtuesit e degëve. Kjo ka bërë që në disa raste të ketë shpërndarje jo të drejtë sipas kapaciteteve reale të agjentëve dhe punonjësve.

Gjatë 2019-ës nga vet degët janë kryer analiza të detajuara, lidhur me faktorët që kanë ndikuar në realizimin / tejkalimin apo mosrealizimin e planit, në të cilat përcaktohen dhe rekomandime për përmirësimin e punës. Përgjithësisht ka pasur një angazhim dhe përkushtim të drejtuesve të njësive vendore për të vënë në pozita pune specialistët dhe agjentët e degëve, gjë që rrit mundësinë që kompania të identifikojë në kohë faktorët me impakt negativ apo pozitiv në realizimin e objektivave të vendosura.

Kontrolli dhe analiza e shpenzimeve administrative.

Në rregulloret dhe urdhërat e brendshëm të kompanisë janë përcaktuar limitet e shpenzimeve administrative për disa lloje shpenzimesh. Në pothuajse të gjithë rastet rimbursimi i shpenzimeve është kryer sipas limiteve të përcaktuara dhe është shoqëruar me dokumentacion justifikues të njohur ligjërisht. Jo në çdo rast kontabilizimi i tyre është bërë në përputhje me njësitë organizative, në kohë dhe sipas llojit të shpenzimit përkatës. Si rezultat i kësaj nivelet e shpenzimeve nuk janë pasqyruar saktë sipas degëve, as sipas llojit.

Procedura e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve është përqëndruar në Drejtorinë Qendrore dhe është e formalizuar. Në çdo rast blerjet kryhen duke zbatuar procedurat e përcaktuara në urdhërat e brendshëm dhe shoqërohen me dokumentacionin përkatës. Kjo ka çuar në reduktimin e riskut të humbjes së aktiveve dhe përzgjedhjen e furnitorëve të duhur, gjë e cila ka reduktuar dhe kostot e blerjeve.

Procedura e marrjes në sigurim dhe zbatimi i kushteve të kontratave. Shpenzimet e marrjes në sigurim, efektiviteti i tyre, zbatimi i urdhërave dhe kritereve për përcaktimin e masës së këtyre shpenzimeve.

Procedura bazë e marrjes në sigurim është e përcaktuar në udhëzimet sipas produkteve, në të cilët është përcaktuar dhe sistemi tarifyor. Shumica e udhëzimeve i përkasin periudhës së para privatizimit dhe nuk janë rishikuar. Për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të kushteve të tregut duhet që dhe rregulloret / udhëzimet / manualët e brendshme të

shoqërisë lidhur me procesin e marrjes në sigurim dhe vlerësimin e risqeve të rishikohen dhe përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të zvogëlohet risku i sigurimit dhe kompania t'i përshtatet në kohë ndryshimeve.

Përgjithësisht janë zbatuar procedurat e marrjes në sigurim, por jo në çdo rast është plotësuar dokumentacioni i plotë sipas udhëzimeve të brendshme, si dhe një kopje e dokumentacionit nuk dorëzohet në qendër, por mbahet në degë. Janë konstatuar gabime në lëshimin e produkteve vullnetare, kjo kryesisht vjen si rezultat i mosnjohjes së këtyre produkteve nga specialistët e shitjes. Gabimet e konstatuara nuk janë evidentuar nga qendra dhe si rezultat i kësaj nuk janë korrigjuar në kohë.

Tarifat e aplikuara për produktet vullnetare përgjithësisht janë më të ulëta se tarifat e përcaktuara në udhëzimet e brendshme të produkteve, pasi shumica e udhëzimeve i përkasin periudhës së para privatizimit. Tarifat janë ulur për t'u përshtatur me kushtet e tregut dhe në çdo rast ulja është bërë me miratim të instancave kompetente.

Gjatë vitit 2019 është konstatuar rritja e shpenzimeve të marrjes në sigurim (komisione dhe bonuse) krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së nivelit të shitjeve, por dhe si rezultat i rritjes së nivelit të komisioneve të aplikuara. Rritja e nivelit të shpenzimeve është disa herë më e lartë se norma e rritjes së shitjeve, ndaj ky është një tregues që duhet mbajtur në konsideratë me qëllim që shpenzimet e marrjes në sigurim të mbahen në nivelin e duhur dhe të jenë efektive. Përsa i përket nivelit të komisioneve është konstatuar se përgjithësisht janë aplikuar komisione brenda limiteve të përcaktuara në udhëzimet e brendshme të kompanisë. Niveli i komisioneve është miratuar nga strukturat kompetente dhe në rast të miratimeve të komisioneve të veçanta (të ndryshme nga niveli i miratuar paraprakisht) është plotësuar dokumentacioni justifikues i nevojshëm në zbatim të udhëzimeve të brendshme.

Administrimi i policave të sigurimit dhe vlerave materiale e monetare në qendër, degë dhe agjensi. Zbatimi i procedurave për ruajtjen dhe qarkullimin e tyre, hartimi i dokumenteve përkatës dhe zbatimi i kritereve ligjore.

Vlerat materiale, përfshirë inventarin e imët, kancelaritë, paisjet e zyrave, materialet e konsumit etj., dokumentohen nëpërmjet fletë-hyrjeve të magazinës. Lëvizja dhe konsumi i tyre bëhet mbi bazë të nevojave, kërkesave dhe normave të konsumit. Dalja e tyre bëhet e autorizuar dhe e dokumentuar.

Shpërndarja e policave bëhet mbi bazën e kërkesës së degëve / agjentëve, duke marrë në konsideratë nevojën, shitjen dhe gjendjen aktuale të policave të sigurimit në degë/agjentë. Për policat motorrike (Karton Jeshil dhe Kufitare) furnizimi bëhet nga Brokëri në degë, e cila më pas informon specialistin e administrimit në qendër për të ngarkuar seritë në Sistemin e Brendshëm, ndërsa për produktin TPL furnizimi bëhet nga Brokëri në qendër, e cila bën dhe shpërndarjen në degë. Duke qenë se policat motorrike ngarkohen si gjendje dhe në Brokëri dhe në Sistemin e Brendshëm të kompanisë dhe shpërndarja nuk bëhet në çdo rast nga kompania, kjo rrit mundësinë e mosinformimit dhe mosngarkimit të serive në të njëjtën kohë në të dy sistemet, gjë që çon në krijimin e problematikave të evidentimit të gjendjes së saktë dhe rakordimit ndërmjet dy sistemeve. Lëvizja e policave është e dokumentuar në çdo rast. Procesi i inventarizimit të kryer nuk është dokumentuar në çdo rast sipas udhëzimeve të brendshme të kompanisë, por konfirmimi i gjendjes së policave bëhet çdo fund muaji nga punonjësit e degëve dhe gjatë kontrolleve të kryera nuk ka rezultuar humbje e policave.

Zbatimi i procedurave ligjore dhe nënligjore në ndjekjen e procedurave të trajtimit të dëmeve, ndjekjen e proceseve gjyqësore dhe rasteve të regresit.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna dhe në kuadër të unifikimit të procedurave me kompaninë Eurosig është rishikuar rregullorja "Për trajtimin e dëmeve", ku janë përcaktuar procedurat e trajtimit të dëmeve që nga momenti i marrjes së kërkesës për dëmshpërblim deri në pagesën e dëmit, duke plotësuar dhe boshllëqet e konstatuara në auditimet e mëparshme.

Gjatë trajtimit të dëmeve shëndetësore është konstatuar se një nga problemet kryesore është përcaktimi i shkallës së paaftësisë, pasi përgjithësisht të dëmtuarit nuk pranojnë të ekzaminohen nga mjeku i kompanisë dhe në këto raste vlerësimi i paaftësisë kryhet vetëm mbi bazën e dokumentacionit mjekësorë. Arsyeja kryesore e hapjes së proceseve gjyqësore është mospranimi i vlerës së dëmshpërblimit nga përfituesit për shkak të mospranimit të shkallës së paaftësisë së përcaktuar nga GES apo mjeku i kompanisë. Nga ana e juristëve janë ndjekur të gjithë proceset gjyqësore të kompanisë dhe përgjithësisht janë angazhuar dhe ekspertë të fushave përkatëse (mjek, vlerësuesi i dëmeve etj.) me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të interesave të kompanisë. Për çdo proces gjyqësor të hapur pas datës 01. 01. 2019 nga ana e Departamentit Ligjor është marrë vendimi i përcaktimit të % së aftësisë në punë nga GES dhe nga mjeku i kompanisë.

Gjatë vitit 2019, Drejtoria Juridike krahas ndjekjes së proceseve gjyqësore të kompanisë Insig është angazhuar dhe në ndjekjen e proceseve gjyqësore të rasteve të Fondit të Kompensimit për llogari të BSHS, si dhe në ndjekjen e rasteve të regresit. Janë evidentuar diferencat nga Njësia e Ndjekjes së Padive të Regresit, e cila disponon dhe ka krahasuar database-in e Departamentit të Financës me database-in e Departamentit të Dëmeve dhe të Departamentit Ligjor. Departamenti Ligjor ka kryer rakordimet për rastet e regresit të Fondit të Kompensimit dhe janë përpiluar dhe dërguar shkresat për ekzekutim vullnetar për shkaktarët. Problematika kryesore lidhur me rastet e regresit është se adresat e disponuara nga Insig nuk janë të sakta dhe në të shumtën e rasteve shkaktarët nuk marin dijeni, gjë që pengon procesin e ngritjes së kërkesë padisë në gjykatë.

Vlerësim mbi mjaftueshmërinë e sistemit të teknologjisë së informacionit
Në sistemin e brendshëm të kompanisë janë të implementuar moduli i shitjeve, moduli i dëmeve dhe moduli financiar. Moduli i shitjes është i integruar me modulin financiar, ndërsa moduli i dëmeve nuk është i integruar.

Shitjet për të tjerë nuk pasqyroheshin në Sistemin e Brendshëm të kompanisë dhe si rezultat i kësaj as komisionet e këtyre shitjeve. Jo të gjithë modulet e sistemit janë vënë në funksion dhe jo të gjithë raportet janë testuar dhe përdoren për gjenerimin e informacionit. Janë konstatuar problematika dhe mangësi të Sistemit të Brendshëm lidhur me mungesën e raporteve të nevojshme për strukturat, kufizimet për specifika të ndryshme të produkteve vullnetare etj.. Mungesa e modulit të dëmtimeve në Sistemin e Brendshëm është shoqëruar me kryerjen e procedurave të anulimit apo dublikimit të policave me qëllim shkarkimin e serive të dëmtuara fizikisht që rezultojnë gjendje në sistem.

Integrimi i moduleve në Sistemin e Brendshëm ka ndikuar në përmirësimin e procedurës së marrjes në sigurim, në uljen e riskut të mashtimit dhe gabimit njerëzor, si rezultat i transferimit automatik të të dhënave nga një modul në tjetrin. Me vënien në funksion

të plotë të sistemit do arrihet që të sigurohet informacion i plotë i klientëve dhe në këtë mënyrë vlerësohet saktë risku i tyre gjatë procedurës së marrjes në sigurim, i gjithë informacioni i nevojshëm do gjenerohet në kohë, si dhe do rritet niveli i sigurisë së ruajtjes të të dhënave.

Vlerësim mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të depozituara në AMF. Pasqyrimi i shitjeve në sistemin e brendshëm të kompanisë dhe në AMF

Të dhënat lidhur me shitjet, anulimet, kthimet e policave janë të pasqyruara saktë në Sistemin e Brendshëm të kompanisë dhe janë raportuar saktë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Procesi i rakordimit të të dhënave mes strukturës së Shitjes dhe Departamentit të Financës është i formalizuar dhe nuk janë konstatuar diferenca mes raportimeve të dy strukturave dhe raportimeve në AMF.

Procedura e rakordimit të primit ndërmjet Sistemit të Brendshëm dhe Broker-ave kryhet nga specialistja e administrimit, e cila kryen dhe procedurën e kontrollit të policave të shitura pas raportimit të primeve. Funksonimi në këtë mënyrë bën të pamundur evidentimin e problematikave të shitjes në kohë dhe zgjidhjen e tyre përpara procesit të raportimit të primeve.

Në vazhdimësi ne do kontrollojmë dhe ndjekim rekomandimet e lëna në auditimet e kryera, si dhe njëkohësisht do të fillojmë me auditimin e veprimtarisë për vitin 2020. Për çdo pasaktësi, moszbatim urdhërash, ligjesh apo shkelje të konstatuara do të raportojmë informacion të detajuar dhe do të lëmë rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e punës në vazhdim.

Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesit e likuiditetit dhe treguesit e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

Bazuar në ligjin nr. 52 date 22.05.2014, i ndryshuar dhe rregulloren nr. 19/2015 "Mbi aktivet e lejuara dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike" shoqëria INSIG sh.a rezulton me aktive në mbulim të Provigjoneve teknike mbi 100% më 31.12.2019.

Bazuar në ligjin nr. 52, date 22.05.2014, i ndryshuar dhe rregullores nr. 87/2016 "Mbi elementët e zbritshëm në llogaritjen e kapitalit" shoqëria INSIG sh.a zotëron aftësi paguese dhe likuiditet më 31.12.2019. Vlerat e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, treguesit të likuiditetit dhe treguesit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike mund ti konsultoni edhe në raportin e shoqërisë audituese mbi pasqyrat financiare për periudhën deri më 31.12.2019, të përgatitur sipas SNRF (pjesë e këtij raporti pika 8)